

## STATUT

### BRIDGES CONSULTING SHPK

### SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### Neni 1

#### Emri i Shoqerise

1.1. Emri i Shoqerise eshte **BRIDGES CONSULTING shpk** ("Shoqeria"), ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi "shpk", i cili perfaqeson formen ligjore te saj.

1.2. Ne te gjitha dokumentat, faturat, reklamimet dhe botimet e leshuara nga Shoqeria, pavaresisht nga menyra e dergimit, emri i saj do te ndiqet ose do te shoqerohet nga fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose "shpk".

#### Neni 2

#### Forma Ligjore

2.1. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar.

#### Neni 3

#### Selia e Shoqerise

3.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Njesia 5, Rruga "Ibrahim Rugova", Pallati Arkimed, Ap. 3/5, Tirane, Shqiperi.

3.2. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjetër te Shqiperise.

3.3. Shoqeria mund te hape, filiale, dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

#### Neni 4

#### Kohezgjatja


4.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pacaktuar.

#### Neni 5

#### Objekti i veprimtarise se Shoqerise

5.1. Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete cdo lloj veprimtarie qe nuk ndalohet me ligj.

5.2. Kryesisht Shoqeria do te kryeje, por pa u kufizuar, veprimtarite e meposhtme:



Sherbime keshillimi ne fushen financiare dhe ligjore, ne ate te krijimit te bizneseve te reja dhe permiresimit apo ristrukturimit te atyre ekzistuese. Hartimi i analizave, studimeve dhe projekteve, pergatitje e planeve te biznesit, studimeve te fisibilitetit dhe investimit. Asistence ne negociime marreveshjesh me pale te treta. Konsultime ne fushat e konsolidimit te institucioneve financiare dhe bankare, private e publike. Keshillime ne fushat e organizimit dhe te funksionimit te institucioneve rregullatore ne fushen e ekonomise.

5.3. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, ne menyre qe te arrihet qellimi i siperpermendur, Shoqeria mund te kryeje çdo lloj aktiviteti ne raport me objektin dhe per te favorizuar ate;

## **Neni 6 Ndryshimi i Objektivit**

6.1. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj ne cdo kohe, ne respektim te dispozitave urdheruese te Ligjit per Shoqerite Tregtare dhe parashikimeve te ketij Statuti.

## **Neni 7 Kapitali i Themeltar, Pjeset e Kapitalit Themeltar**

7.1. Kapitali i rregjistruar i Shoqerise eshte ne total 5,000,000 (Pesë milion) Lekë, i perbere nga 1 ("Kuote"), plotesisht e nenshkruar dhe e paguar, e cila perfaqeson te gjithe kapitalin e shoqerise.

7.2. Shoqeria mund te leshoje nje certifikate per te vertetuar zoterimin e cdo Kuote ne Kapitalin e Regjistruar.

7.3. Shoqeria nuk mund te bleje apo zoteroje asnje Kuote te saj. Megjithate me qellim zvogelimin e Kapitalit te Shoqerise, nepermjet vendimit te Ortakut te vetem, ky i fundit mund te autorizoj Administratorin te bleje Pjeset e kapitalit perkatese me qellim anullimin e tyre.

## **Neni 8 Ortaket**

8.1. Ortake te Shoqerise jane vetem ata te cilet zoterojne Pjeset e Kapitalit te Rregjistruar te Shoqerise. Ortaku i vetem themelues i Shoqerise eshte :

- **Z. Adrian Fullani**, i biri i Janit, shtetas shqiptar, lindur me 15.01.1955, ne Tirane, banues ne Tirane ne adresen: Njesia Nr.5, Rruga Ibrahim Rugova, Kulla Green Park, Ap. 46, mbajtes i kartes se identitetit me Nr. F50115067C, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, **mbajtes i 1 Kuote qe perfaqeson 5,000,000 (Pesë milion) Lekë ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise, pra 100% te tij;**

8.2. Ortaku i vetem nuk pergjigjet per detyrimet e Shoqerise dhe mbulon personalisht humbjet deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te paguara. Kontributet e ortakut perbejne Kapitalin e Rregjistruar te Shoqerise.



8.3. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera, me karakter vetjak, të Ortakut të saj.

8.4 Pjesët e kapitalit janë lirish të transferueshme në çdo moment sipas kushteve të parashikuara nga ligji shqiptar.

#### **Neni 9**

#### **Kuotat, të drejtat dhe kufizimet**

9.1. Në varësi të dispozitave të Ligjit dhe pa cenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, çdo kuotë mund të emetohet me të drejta ose kufizime të tilla siç përcaktohet në vendimin e Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 10**

#### **Kalimi i kuotave me kontratë**

10.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe në bazë të formaliteteve të vendosura nga Administratori. Kalimi i kuotës i njoftohet shoqërisë në selinë e regjistruar të saj.

10.2 Administratori mund të mos pranojë ta regjistrojë kalimin e kuotës pranë QKR-së nëse kuota nuk është shlyer tërësisht.

10.3 Nëse Administratori nuk pranon ta regjistrojë kalimin e kuotës, ai, brenda një muaji pas datës në të cilën është bërë kërkesa për regjistrimin e kalimit në shoqëri, i dërgon marrësit njoftimin për mospranimin.


#### **Neni 11**

#### **Kalimi përmes trashëgimisë ose falimentit**

11.1 Nëse ortaku vdes, trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij. Por asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga detyrimet në lidhje me kuotën që ai ka patur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.

11.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotëruesi i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotëruesi vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotëruesi i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës të ky person tjetër.

11.3 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat titullar i të cilave do të kishte qenë si zotëruesi i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në asamblenë e shoqërisë.



## Neni 12

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

12.1 Ortaku i Vetëm vendos për zmadhimin e kapitalit me vendim të tij.

12.2 Shoqëria vendos për zvogëlimin e kapitalit të saj me anë të vendimit të ortakut të vetëm.

## Ortaku i Vetëm

### Neni 13

13.1 Ortaku i Vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve kryesore për shoqërinë.

13.2. Ortaku i Vetëm vendos për të gjitha çështjet e parashikuara në Nenin 81 të Ligjit si për çdo çështje tjetër të parashikuar në këtë Statut, apo çështje të tjera për të cilat ai vetë mund të vendosë.

## Neni 14

### Emerimi, Kohezgjatja e Mandatit dhe Shkarkimi

14.1. Shoqëria drejtohet nga 1 (nje) Administrator. Detyrat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në Statut dhe në Aktin e Emerimit.

14.2. Administratori është:

- Znj. Enkelejda Bode, madhore e me zotesi të plote për të vepruar;

14.3. Kohezgjatja e emerimit të Administratorit është për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh, me të drejtë ripërteritje të këtij mandati.

14.4. Administratori mund të shkarkohet, në çdo kohë, me miratimin e Ortakut të vetëm.

## Neni 15

### Te Drejtat dhe Detyrimet e Administratorit

15.1. Administratori vepron si firmetar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë që nuk kërkon miratimin e Ortakut të vetëm.

15.2. Te drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë :

- (i) Te therrasi Asamblenë e Përgjithshme dhe të kërkojë miratim prej saj për çdo çështje të parashikuar në ligj dhe në Statut, duke përfshirë por pa u kufizuar në çdo transaksion që arrin dhe/ose tejkalon shumën/at 5 000 Euro;



- (ii) Te menaxhoje aktivitetin tregtare te Shoqerise duke implementuar strategjite, politikat dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
- (iii) Te sigurohet qe pasqyrat financiare te mbahen ne menyren e duhur: Te firmose bilancet vjetore, llogarite e konsoliduara dhe raportet e performances, se bashku me rekomandimet per Asamblene e Pergjithshme per shperndarjen e fitimeve;
- (iv) Te krijoje nje sistem paralajmerues ne lidhje me ngjarjet qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (v) Depozitim e te dhenave te Shoqerise prane Qenderes Kombetare te Regjistrimit sipas nevojës;
- (vi) Te raportojë përpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me implementimin e politikave te biznesit dhe realizimin e transaksioneve me rendesi te vecante per Shoqerine, te cilat jane autorizuar paraprakisht prej Asamblese se Ortakeve;
- (vii) Te zbatojë detyra te ngarkuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve dhe Ligji sipas rastit.

15.3. Administratori mbikqyr dhe siguron qe zyrtaret, agentet, te punesuarit, auditoret dhe keshilltaret e Shoqerise te veprojne me kujdesin e duhur dhe te mbrojne sa me mire interesat e Shoqerise.

#### **Neni 16**

#### **Dividendi**

16.1 Në fund të vitit financiar, Ortaku i Vetëm ka të drejtë të ndajë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuoten që ai zotëron në shoqëri.

16.2 Nëse një dividend nuk është tërhequr pas dymbëdhjetë vjetëve nga data kur mund të tërhiqet pagesa, nëse Asambleja e Përgjithshme vendos me vendim të kualifikuar, ky dividend mund të anulohet dhe shoqëria nuk është më e detyruar ta paguajë.

#### **Neni 17**

#### **Kapitalizimi i fitimeve**

17.1. Ortaku i Vetëm mund të vendosë të kapitalizojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për të paguar dividendë preferencialë ose borxhe të tjera të pashlyera ende nga shoqëria nga kapitali i detyruar i shoqërisë.


#### **Neni 18**

#### **Prishja dhe likuidimi**

18.1 Prishja dhe likuidimi i shoqërisë vendoset me vendim të Ortakut të Vetëm.

18.2 Likuidimi i Shoqërisë do të bëhet nga likuiduesi(t) e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

18.3 Likuiduesi(t), bazuar në vendimin e Ortakut të Vetëm dhe në përputhje me Ligjin, mund t'i



shpërndajë Ortakut të Vetëm gjithë vlerën ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe, për këtë qëllim, mund t'i vlerësojë pasuritë dhe të përcaktojë se si të bëhet një shpërndarje e tillë tek ortaku.

#### **Neni 19**

#### **Baza ligjore**

19.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë Statut dhe me ligjin shqiptar.

19.2 Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, do të aplikohen normat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

#### **Neni 20**

#### **Viti Financiar**

20.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

#### **Neni 21**

#### **Ndryshimet**

21.1. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet, shfuqizohet i teri e të zevendesohet me një statut të ri vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

#### **Neni 22**


#### **Ligji i Zbatueshem dhe Gjykata Kompetente**

22.1. Te gjitha mosmarreveshjet që lindin në lidhje me vlefshmerinë, interpretimin apo zbatimin e Statutit zgjidhen me mirekuptim, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarreveshjeve do të jetë Gjykata Shqiptare.

22.2. Ky Statut është hartuar në 4 kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtte ligjore.

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE BRIDGES CONSULTING shpk**

**Z. Adrian Fullani**



(emer, mbiemer, nënshkrim)

07.26/09/2018